

AKT NORMATIV
Nr. 6, datë 4.10.2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.119/2012, “PËR BUXHETIN E VITIT 2013”

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.119/2012, “Për buxhetin e vitit 2013”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 1

Buxheti për vitin 2013 është:

Të ardhurat	321 919	milionë lekë;
Shpenzimet	405 408	milionë lekë;
Deficiti	83 489	milionë lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale: sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve.”.

Neni 2

Neni 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2013 është:

Të ardhurat	252 113	milionë lekë;
Shpenzimet	335 602	milionë lekë;
Deficiti	83 489	milionë lekë.”.

Neni 3

Neni 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2013 është:

Të ardhurat	28 580	milionë lekë;
-------------	--------	---------------

nga të cilat:

- granti i pakushtëzuar nga buxheti qendror 16 153 milionë lekë;
- të ardhura të tjera 12 427 milionë lekë;

Shpenzimet 28 580 milionë lekë.”.

Neni 4

Neni 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2013 është:

1. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

Të ardhurat, gjithsej 88 876 milionë lekë;

nga të cilat:

- kontributet 50 669 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit 38 207 milionë lekë;

Shpenzimet 88 876 milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe ndryshon sa herë që rriten pagat dhe pensionet. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të përcaktojë një kontribut të veçantë minimal për personat e vetëpunësuar në bujqësi dhe për kategoritë specifike të personave të vetëpunësuar. Diferenca ndërmjet kontributeve të veçanta me kontributin minimal mbulohet nga transfertat e buxhetit të shtetit, por jo më shumë se kufijtë e transfertave të përcaktuara në këtë ligj. Për vitin 2013, teprica e të ardhurave, sipas degëve të sigurimit shoqëror, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat, gjithsej 5 108 milionë lekë;

nga të cilat:

- kontributet 400 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit 4 708 milionë lekë;

Shpenzimet 5 108 milionë lekë.”.

Neni 5

Neni 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2013 është:

Të ardhurat, gjithsej 30 736 milionë lekë;

nga të cilat:

- kontributet dhe të tjera 7 310 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit 23 426 milionë lekë;

Shpenzimet 30 736 milionë lekë.

Fondi për shërbimin spitalor jepet me hollësi dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Neni 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 6

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve për vitin 2013 është:

Të ardhurat, gjithsej 1 900 milionë lekë;

nga të cilat:

- të ardhura të tjera 1 600 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit 300 milionë lekë;

Shpenzimet 1 900 milionë lekë.”.

Neni 7

Neni 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 8

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet 7 880 milionë lekë;
Të ardhurat tatimore 220 105 milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore 24 128 milionë lekë.”.

Neni 8

Neni 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 9

Kufiri i financimit të deficitit të buxhetit të shtetit nga burime të brendshme dhe të huaja është 83

489 milionë lekë, nga i cili 12 465 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit. Në rast mosrealizimi të të ardhurave të buxhetit dhe të të ardhurave nga privatizimi, huamarrja totale për financimin e deficitit prej 71 024 milionë lekësh nuk ndryshon. Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve.

Të ardhurat nga privatizimi, mbi shumën e parashikuar në këtë buxhet, përdoren me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale dhe/ose uljen e huamarrjes, e cila, nëse shkon për shpenzime kapitale, automatikisht, rrit kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2, të këtij ligji.”.

Neni 9

Neni 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 10

Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Shpenzimet korrente	256 119 milionë lekë;
Shpenzimet kapitale	74 283 milionë lekë;
Fondi rezervë	2 000 milionë lekë;
Kontingjenca	800 milionë lekë;
Fondi për rritjen e pagave dhe pensione	2 400 milionë lekë.

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Në zbatim të nenit 37, të ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, krijohet fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor, i cili përdoret sipas përcaktimeve të Ministrit të Financave, bazuar në rekomandimet e Komitetit Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar. Për vitin 2013, në këtë fond, nga të ardhurat e grumbulluara nga aktiviteti i administrimit të pasurive të konfiskuara, derdhen nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara 42 milionë lekë. Nga të ardhurat e krijuara nga administrimi i pasurive të konfiskuara, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara do të përdorë, për qëllime të administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, 42 milionë lekë, ndërsa pjesa tjetër derdhet në buxhetin e shtetit.

Këshilli i Ministrave vendos norma dhe standarde financiare për shpenzimet publike, të cilat janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.”.

Neni 10

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 10/1

Në buxhetin e shtetit të vitit 2013, në treguesin e të ardhurave tatimore dhe treguesin e shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes së Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, përfshihet shuma prej 465 269 393 lekësh, që përfaqëson detyrimin e shitësit në procesin e privatizimit të katër hidrocentraleve, si tatim në masën 10% mbi shitjen e pasurisë së shoqërive “HEC, Bistrica 1 e Bistrica 2”, sh.a., dhe “HEC, Ulëz - Shkopet”, sh.a.”.

Neni 11

Neni 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 11

Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë është 87 710 veta. Numri maksimal i punonjësve, i dhënë me hollësi për çdo ministri dhe institucion qendror, është sipas tabelës 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Këshilli i Ministrave mund të rialokojë numrin e punonjësve ndërmjet institucioneve të përmendura në tabelën 2, në rastin e ristrukturimit të institucioneve ekzistuese apo krijimit të institucioneve të reja. Numri rezervë, i parashikuar në tabelën 2, përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave vetëm për institucione të reja të krijuara me ligj. Këshilli i Ministrave përcakton numrin maksimal të punonjësve me kontratë të përkohshme për çdo ministri dhe institucion qendror. Fondi i veçantë i institucioneve buxhetore prej 1 100 milionë lekësh shpërndahet dhe përdoret me miratimin e Ministrit të Financave dhe sipas procedurave që përcaktohen me udhëzim të tij.”.

Neni 12

Neni 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 12

Paga e Presidentit të Republikës është 257 000 lekë në muaj.”.

Neni 13

Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 13

Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave prej 2 000 milionë lekësh përdoret për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore. Fondi i kontingjencës prej 800 milionë lekësh përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave. Fondi për rritjen e pagave e të pensioneve prej 2 400 milionë lekësh shpërndahet nga Ministri i Financave, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 14

Shuma për Fondin për Zhvillimin e Rajoneve, e përcaktuar në rreshtin e tretë, të tabelës nr.3, të përmendur në nenin 15, nga “2 000 milionë lekë” bëhet “4 000 milionë lekë”.

Neni 15

Neni 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 18

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2013, është 101 018 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

1. Për huamarrjen vjetore neto për mbështetjen buxhetore, deri në 52 820 milionë lekë.
2. Për huamarrjen neto për financimin e projekteve të huaja, deri në 39 497 milionë lekë.

3. Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, deri në 8 441 milionë lekë.

4. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra, të huaja të papaguara, deri në 260 milionë lekë.

Stoku i borxhit shtetëror, përfshirë kursin e këmbimit, vlerësohet të arrijë deri në 867 105 milionë lekë. Stoku i borxhit të garantuar, përfshirë kursin e këmbimit, vlerësohet të arrijë në 61 894 milionë lekë.

Përfshihen nga kufijtë e sipërpërmendur garancitë që mund të jepen për sigurimin e furnizimit me energji elektrike. Autorizohet Këshilli i Ministrave që në këto raste të japë garanci përtej limiteve të parashikuara më sipër.”.

Neni 16

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 17

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama